



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "TSR" Sh.P.K. të datës 28.05.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 10.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri" me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "TSR" Sh.P.K. e datës 28.05.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 10.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri" me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "TSR" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "TSR" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 28.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 10.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri" me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Me këte rast Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij paragrafi dhe te Nenit 7 te LPP_se ne pergjithesi pasi qe Lind pytja se si esht e mundur qe AK te Merr thujase ne tersi specifikacionet tekni vetem te nje Prodhuesi te samavorve(Ket rast LA SEMAFORICA) dhe te vendos specifikacionet teknike identike me produktet e keti prodhuesi ,AK asht dasht qe te bej sdudim me I thelluar te Produkteve , pasiqe ka edhe kompani qe ofrojne produkte te njejta Apo me sisteme te njejta Por me emera te ndryshem nga ato qe kerkohen ne DT, andaj vet fakti qe AK thujase ne specifikacione teknike kerkon eksakt Produktet e Prodhuesit LA SEMAFORICA ben shkele te keti Neni qe ne fillim te Procedures”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7 dhe 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 06.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Duke marrë parasysh që pretendimet e parashtruesit kanë qenë të ndërlidhura me specifikat teknike të dosjes së tenderit fillimisht sqarimet nga njësia kërkuar lidhur me këto pretendime të parashtruesit. Me datë 06.06.2023 njësia kërkuese ka dërguar te zyrtari përgjegjës i prokurimit përgjigjen si në vijim *“Pretendimet ankimore te OE ankues jane te pabazuara pasiqe specifikat teknike te dosjes se tenderit jane te hartuara pikerisht duke i respektuar rregullat dhe standardet nderkombetare si dhe konform Ligjit te Prokurimit Publik te Republikes se Kosoves. Te njejten kohe eshte mundesuar qe per produktet e kerkuara te ofertohet me prodhime ekuivalente ose me te avancuara (shih specifikimin teknik) te cilat i plotesojne prodhuesit konform standardeve te aplikuara te kualitetit dhe te cilat jane kompatible me pajisjet ekzistuese semaforike. Edhe njehere ju potencojme se ne specifikimet teknike te dosjes se tenderit per produktet semaforike te kerkuara eshte e potencuar qe pajisjet te jene: me karakteristika minimale ose me e avancuar dhe rrjedhimisht pranohen edhe produktet ekuivalente siq eshte e potencuar ne dosje te tenderit”.* Tutje si provë materiale është administruar edhe Dosja e Tenderit (“DT”) me ç’rast nuk është evidentuar ndonjë shkelje ligjore e dukshme *prima facie*. Në këtë mënyrë duke u bazuar në sqarimet e njësisë kërkuese e cila i ka hartuar specifikat teknike të DT, është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara. Kjo për arsye se parashtruesi nuk ka arritur që të paraqes argumente apo të dërgoj dëshmi sipas të cilave do të mund të mbështeteshin pretendimet e tij duke vërtetuar të kundërtën e sqarimeve të njësisë kërkuese. Duhet theksuar që parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim pretendon që specifikat e tenderit janë përshtatur për një prodhues të caktuar dhe akuzon autoritetin kontraktues që nuk ka bërë hulumtim të mjaftueshëm para se të përcaktoj kërkesat përkatëse të DT. Megjithatë parashtruesi nuk ka arritur që të argumentoj përse pretendon që specifikat teknike si të tilla janë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LPP. Nëse parashtruesi një akuzë e tipit që AK ka përshtatur specifika teknike për një OE të caktuar, atëherë së paku duhet tentuar që të sqarohet se konkretisht ku e ka bazuar parashtruesi një pretendim/akuzë të tillë. Tutje parashtruesi ka pretenduar që autoriteti kontraktues nuk ka bërë hulumtim të mjaftueshëm para se të përcaktoj kriteret e DT. Megjithatë parashtruesi në asnjë rast nuk ka arritur që të njoftoj autoritetin kontraktues se për cilin gabim apo shkelje ligjore po bëhet fjalë në rastin konkret. Me fjalë të tjera kur thuhet se

AK nuk ka hulumtuar mjaftueshëm dhe ka gabuar me një kërkesë të caktuar, atëherë parashtruesi së paku duhet të prezantoj një propozim se si duhet të ndryshohet kërkesa e tillë sipas tij. Pra parashtruesi në njërën anë ka akuzuar AK për gabime në DT dhe në anën tjetër nuk ka treguar se cilat janë këto gabime dhe aq më pak nuk ka propozuar se si duhet të ndryshohet DT në mënyrë që përmisohen këto gabime sipas parashtruesit. Në këtë mënyrë duke marrë parasysh edhe sqarimet e njësisë kërkuese është gjetur se pretendimet e parashtruesit si të tilla janë kundërthënëse dhe të pabazuara në tërësi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.06.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.